



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
- KOMISIONI I KONKURENCËS -

---

**VENDIM**

**Nr. 189 datë 26.05.2011**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PER FUNKSIONIMIN E  
AUTORITETIT TË KONKURENCËS”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- |                            |         |
|----------------------------|---------|
| • Znj. Lindita MILO (LATI) | Kryetar |
| • Znj. Servete GRUDA       | Anëtar  |
| • Z. Koço BROKA            | Anëtar  |
| • Znj. Rezana KONOMI       | Anëtar  |

Në mbledhjen e tij të datës 26.05.2011, në mbështetje të nenit 24, germa “c”, me propozim të Sekretariatit,

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në Rregulloren “Për funksionimin e Autoritetit të Konkurrencës”, neni 9 ndryshohet si vijon:

**“Neni 9**

***Thirrja e mbledhjeve***

- 1. Kryetari është i detyruar të thërrasë një mbledhje kur kjo kërkohet me shkrim nga të paktën 1(një) anëtar i Komisionit, duke përcaktuar çështjet për të cilat thirret kjo mbledhje. Si objekt i mbledhjes konsiderohen çështje për të cilat Komisioni është i mandatuar sipas Ligjit. Në mënyrë të veçantë, hapja e Hetimit mund t'i kërkohet Komisionit nga Kryetari, ose çdo anëtar.*
- 2. Këto kërkesa paraqiten me shkrim në Kabinet dhe shqyrtohen nga Komisioni në një mbledhje me rend dite: shqyrtim kërkesë.*
- 3. Lajmërimet për thirjen e mbledhjeve për shqyrtimin e kërkesës bëhen brenda 7(shtatë) ditëve pas paraqitjes së kërkesës nga anëtarët e Komisionit dhe të paktën 3 (tre) ditë para datës së thirrjes së mbledhjes. Ato duhet të tregojnë në mënyrë të qartë dhe të detajuar çështjet për të cilat do të diskutohet.”*

**Neni 2**

1. Në nenin 22 të rregullores, pas pikës 1 shtohet një pikë për kompetencat e drejtuesit të Grupit të Punës me numërtimin 1/1:

*1/1 Drejtuesi i një Grupi Pune ka këto kompetenca administrative:*

*a. Administron dhe drejton procesin monitorues, ose hetimor të Grupit të Punës në përgjithësi dhe anëtarëve të Grupit të Punës në vecanti;*

*Ai evidenton në dosjen hetimore, në proces-verbalet e inspektimit, në proces verbalet e mbledhjeve të grupit të punës dhe në raportet hetimore gjithë materialin e nevojshëm, si dhe mendimet e dhëna nga anëtarët e Grupit të Punës;*

*b. Këshillohet me drejtorët e anëtarëve të tij të grupit të punës për rradhën e planifikimit e cdo veprimi hetimor, ose inspektues të paktën deri një ditë para realizimit të parashikuar;*

*c. Përgjigjet për përgatitjen e shkresave dhe propozon tek Sekretari i Përgjithshëm përmbajtjen e tyre, që, për nevoja të hetimit, vënies në dijeni, ose inspektimit, do t'i adresohen ndërmarrjeve në hetim, ose institucioneve të treta që mund të ndihmojnë me prova hetimin dhe inspektorët.*

2. Po në këtë nen në pikën 3 të tij, bëhen këto shtesa:

a- Pas fjalisë së parë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

*“Në punën e tij të përditshme Grupi i Punës duhet:*

*- të mbajë parasysh dhe tu qëndrojë standarteve me të mira të procedurës hetimore paraprirëse,*  
*- të realizojë rrahjen e mendimeve dhe shkallën e lartë të ballafaqimit të tyre me ekspertizën;*

*b- në fjalinë e fundit shtohet shprehja: “ose hartohen si kapitull më vete dhe i bashklidhen mendimit të shumicës në konkluzionet e raportit përfundimtar, si dhe konsiderohen pjesë integrale e këtij të fundit.”*

3. Në fund të pikës 4 të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje: *“Sekretari i Përgjithshëm në të gjithë hapat procedurale të Grupit hetimor të Punës mbikqyr, vëzhgon dhe kontrollon veprimtarinë e tij, por njëkohësisht duke siguruar dhe pa cënuar pavarësinë e grupit të punës gjatë këtyre procedurave”.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURENCËS**

Servete Gruda  
(                    )  
Anëtar

Koço Broka  
(                    )  
Anëtar

Rezana Konomi  
(                    )  
Anëtar

**Lindita Milo (Lati)**

**K R Y E T A R**